

**AKT - THEMELIMI
I SHOQERISE
ARBERI KONSTRUKSION Shpk**

Në Fier në, sot më date 09.09.2025, janë të pranishëm shtetasit:

1. Arbër Baçinofki atësia Ilmi i datëlindjes 20.07.1993, lindur në Fier, Shqipëri, dhe banues ne Fier, Shqipëri, mbajtës i ID. J30720028E ,I cili, në cilësinë e "Ortakut Themelues", redaktoi këtë Akt themelimi , nëpërmjet të cilit ai deklarua se me vullnet të lire të plotë dhe iniciativën e lire private, mbështetur ne Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil, Ligjin 9901 datë 14.04.2008, " Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Ligjin Nr. 131/ 2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit (Q.K.B.)", si dhe ndryshimet përkatëse, Si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore e fuqi, krijojë/themelojë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin **ARBERI KONSTRUKSION Shpk**

KREU I

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti

Neni 1 Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **ARBERI KONSTRUKSION Shpk**

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria **ARBERI KONSTRUKSION Shpk** është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga personi fizik i sipërpërmendur, I cili përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota.



Neni 3

Selia

Selia e shoqërisë është ne adresen

Lagjja 29 Nentori, Fier, zona kadastrale 8533, volumi 27, faqe 121, nr pasurie 5/460-N2 Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra, përfaqësi, dege, filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është në fushën si vijon:

- Montim dhe Qeradhenie Skeleri

Neni 5

Kohëzgjata

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1 000 Lekë i përbërë nga gjithsej 1 kuote.

Kapitali themeltar është nënshkruar dhe i ndarë nga ortakët e shoqërisë si vijon:

- **Arbër Baçinofki** zotërues i 1 kuote, që përbën 100% të kapitalit në vlerën 1.000 Lekë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit; dh) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga transferimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotës, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie

NENI 8

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga 1 administrator.

Administrator i shoqërisë është zgjedhur Arbër Baçinofki, mbajtes I kartes se identitetit J30720028E, i cili do të ushtrojë funksionet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritje.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administratori shkarkohet me kërkesë të ortakut maxhoritar për shkelje të statutit të shoqërisë, shkelje të ligjit, prishje imazhi dhe mos plotësim të detyrave të caktuara.

Emertimi / shkarkimi i Administratorit behet nga asambleja e ortakëve.

NENI 9 SIGURIMI I PASURISE SE SHOQERISE

9/1 Pasuria e shoqërisë do të sigurohet në Institutin e Sigurimeve të Republikës si dhe në institute të tjera private ekzistuese apo që do të krijohen në të ardhmen sipas legjislacionit në fuqi

9/2 Masa e pasurisë që do të sigurohet si dhe koha e sigurimit të saj do të vendoset nga Administratori

Neni 10

MBYLLJA EKONOMIKE VJETORE E SHOQERISE

Si rregull, veprimet ekonomike të shoqërisë do të mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Përjashtim nga ky rregull do të bëhet kur e kërkon organi kompetent ligjor.

Neni 11

LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqëria do të shpërbëhet sipas rasteve që do të përcaktohen në statutin e saj.

NENI 12

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" të ndryshuar, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14

Dispozita përfundimtare

Ky Akt themelimi , u redaktua në 3 kopje me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

ORTAKET

Arbër Baçinofki

